REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. Faq. Broj stranica Nr. pages 02
Nr. Prot. Br.Prot. Prot. No. 06-01/165/21
Data Datum Date 28.01.2021
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19, paragrafi 11, të Rregullores Nr. 01/2014, së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.01.2021, mori:

V E N D I M

I. **Mbyllet rasti me *Nr. AKK–DPKI-06-1745/20*, për zyrtarin e lartë publik z. Rifat Krasniç, Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

II. **Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m i

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, z. Rifat Krasniç, Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës të pranuar nga jashtë me pretendime për konflikt të interesit, sipas së cilës zyrtari i lartë z. Rifat Krasniç, është dyshuar për mundësinë e ekzistimit të situatës së konfliktit të interesit, meqenëse i njëjti krahas ushtrimit të funksionit publik si Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mban edhe postin e Drejtorit të Institucionit Arsimor, Gjimnazit "ATATÜRK", në Komunën e Mamushës.

Pas kësaj, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese nga zyrtari i lartë, është organizuar takim në Agjencinë kundër Korrupsionit, ku i njëjti ka deklaruar se sa i përket dyshimeve të ngritura për konflikt të interesit, lidhur me pozitat që mbanë

në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përkatësisht në Gjimnazin "ATATÜRK", në Komunën e Mamushës, konsideron se ato janë në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi. Për më tepër, zyrtari i lartë përmes shkresës së dërguar në Agjenci me nr. DPKI-06-01/2685/20, ka bashkangjitur dokumente tjera relevante, duke dhënë sqarime plotësuese për rastin në fjalë.

Agjencia kundër Korrupsionit, në vlerësimin e situatës së konfliktit të interesit ka marr për bazë nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit publik, i cili përcakton se *"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të".*

Gjithashtu, Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 61, pika 8, e cila përcakton ndalesat apo kufizimet e anëtarit të KQZ-së, e që në rastin konkret nuk parashihen ndalesa apo kufizime për zyrtarin e lartë z. Rifat Krasniç, me rastin e ushtrimit të funksionit Drejtor i Institucionit Arsimor, krahas ushtrimit të funksionit publik Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këtë mënyrë, Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet në dispozicion si dhe duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vije në përfundim se në rastin konkret mbajtja e pozitës së Drejtorit në Institucionin Arsimor Gjimanzin "ATATÜRK", krahas ushtrimit të funksionit publik si Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara, përveç se ekziston kufizimi për sa i përket shpërblimit me pagesë, ashtu siç përcaktohet në nenin13, paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit publik, të cilin duhet ta ketë parasysh zyrtari i lartë në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet ekzistimi i situatës së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159, për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit